

€429

per person

BARCELONË - COSTA BRAVA Nisje: • 17 Shtator • 8 Tetor

DESTINACIONI

Barcelone

PERIUDHA

Shtator - Tetor '2026

KOHËZGJATJA

4 Dite

TRANSPORTI

Me Avion



SHTATOR 2026



Nisje 17 Shtator - Kthim 20 Shtator

• 4 Ditë / 3 Netë

• Çmimi: **449€**



• Nisja: 11:30 (Tiranë) → 14:10 (Barcelonë)



• Kthimi: 22:20 (Barcelonë) → 20:10 (Tiranë)



TETOR 2026



Nisje 8 Tetor - Kthim 11 Tetor

• 4 Ditë / 3 Netë

• Çmimi: **429€**



• Nisja: 11:30 (Tiranë) → 14:10 (Barcelonë)



• Kthimi: 22:20 (Barcelonë) → 20:10 (Tiranë)

1

Dita 1: COSTA BRAVA

DITË

Takimi në aeroportin e Tiranës me shoqëruesin minimumi 2 orë përpara fluturimit.

Fluturimi direkt Tiranë - Barcelonë. (2 orë : 20 min)

Pas procedurave doganore, transferti në hotel në Costa Brava.

Vizitë të Rivierës bregtare të magjishme të Barcelonës, te qyteteve : Lloret del Mar dhe Santa Susanna.

Pas vizitave, akomodim në hotel.

2

Dita 2: BARCELONE

DITË

Mëngjesi në hotel.

Në shoqërinë e guidës udhëtojmë me autobus për të vizituar Akvariumin e Barcelonës ku do të qëndrojmë edhe për drekë. Në pasdite do të kalojmë nga lagjia tradicionale e Barcelonës, Barceloneta. Vizitojmë Katedralen e Shën

Eulalisë, Urën e Peshkopëve, Sheshin San Jaume, si dhe lagjen gotike të Barcelonës si dhe Muzeun e Pablo Picasso.

Akomodimi në hotel në Barcelonë.

Mbrëmje e lirë.

3

Dita 3: BARCELONE

DITË

Mëngjesi në hotel.

Nisemi për të vizituar një nga atraksionet më të jashtëzakonshme arkitektonike të Barcelonës ku do na krijohet ideja se jemi në Dubai, do vizitojmë kompleksin hotelier WELA, i lartë 99 m dhe i ndërtuar në vitin 1999. Pas kësaj do të vizitojmë Krenarinë e Barcelonës ,kryeveprën e Antonio Gaudi, Bazilikën Sagrada Familia e cila është parashikuar të përfundojë me rastin e 100 vjetorit të fillimit të punimeve në vitin 2026 .Pas vizitës në Sagrada di Familia do të nisemi për të vizituar parkun Guell, një park i nisur nga Gaudi por që nuk arriti të përfundohej. Më pas vizita jonë do të vazhdojë në Mitikun e Barcelonës në stadiumin Camp Nou.

Gjatë pasdites, shëtitje në bulevardin Passeig de Gracia, bulevardi me markat më të mira në qytet si dhe vendi ku gjenden Vilat me arkitekturën më të veçantë në qytet si Casa Mila, Majestic hotel, Casa Batllo, Casa Amatller, Casa Lleo i Morera dhe sheshi qendror i qytetit, Plaça Catalunya, vendi ku gjendet statuja e Cesk Macia.

Në mbrëmje do mund të bëjmë një vizitë në Fontana Magica, për të shijuar shfaqjen me drita të një prej atraksioneve më mbresëlënëse të Barcelonës.

Pas vizitave kthimi në hotel.

Mëngjesi në hotel.

Në mëngjes do të vizitohet fillimisht Sheshin Espanja si dhe kodrën Montjuik ku gjenden Muzeu Kombëtar i Artit Katalan, Kullat Veneciane, Panairi i Barcelonës i vitit 1926, Stadiumet e Lojërave Olimpikë Barcelona '92. Do të zbresim kodrën edhe do të vizitohet Portin e Krociereve ku gjendet Mirador de Colom, statuja e Kristofor Kolombit, Bulevardin Las Ramblas si dhe sheshi i mrekullueshëm Reial.

Transferta më pas për në aeroportin e Barcelonës.

Pas procedurave doganore, Fluturimi direkt Barcelonë – Tiranë. (2 orë : 25 min)

ÇFARË PËRFSHIHET

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë – Barcelonë – Tiranë. Transferta dhe Shëtitjet me autobus sipas programit. Akomodimi në hotel 4 Yje për të gjitha natët në Barcelonë. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Guida në gjuhën shqipe gjatë Turit Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes – Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat/Hyrjet në monumente dhe muzeume. Taksa lokale 5€ personi për natë (e detyrueshme dhe paguhet në zyrë bashkë me pagesën e turit)

VENDTAKIMI I NISJES

► Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

► Fëmijët në moshën 2 - 11.99 vjeç përfitojnë 40€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn ne fuqi vetëm nëse femijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj

2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do jetë standart, atëherë do jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadenca e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Cmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me

INFORMACIONE

DESTINACIONI	Barcelone
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€429.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	98% (€10.00)

